



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi Amerikane (1)

Ngarkesa: 4 Kredite, 40 orë mësimore: 20 Leksione + 20 Seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze Studime Britanike dhe Amerikane; Përkthim dhe Interpretim

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore : Lënda synon t'i njohë studentët me lëvizjet, periudhat dhe autorët kryesorë të letërsisë amerikane nga fillimet e saj deri më sot. Ajo i mbulon të tria gjinitë: prozën, poezinë dhe dramën, duke u përqendruar veçanërisht në zhvillimin e tyre gjatë shekujve XIX dhe fillimin e shekullit XX. Tekstet letrare vendosen në kontekstin e gjerë shoqëror dhe historik të kohës së tyre dhe konceptohen si shfaqje të rëndësishme të kulturës së tyre.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të analizojnë veprat letrare amerikane në lidhje me kontekstin historik, kulturor dhe shoqëror të periudhës përkatëse.
- 2.Të identifikojnë dhe interpretojnë tiparet kryesore të prozës, poezisë dhe dramës në letërsinë amerikane, me theks të veçantë në shek. XIX dhe fillimshkullin XX.
- 3.Të krahasojnë lëvizjet dhe autorët letrarë amerikanë me zhvillime të ngjashme ose të kundërta në letërsinë europiane dhe të analizojnë ndikimin e tyre në formësimin e identitetit kulturor amerikan.

Rezultatet e pritshme:

Me përfundimin e lëndës, studentët do të jenë në gjendje të

- *njohin* prirjet kryesore letrare të shekulli të 19 (Romanticizmin, Transhentalizmin, Realizmin, Natyralizmin);
- *diskutojnë* rreth karakteristikave të zhvillimeve letrare të shekullit të 19 dhe mënyrës se si ato pasqyrojnë sfonding historik dhe shoqëror të periudhës kohore;
- *analizojnë* elementet letrare dhe kulturore në veprat e autorëve të zgjedhur sipas listës së përmbajtjes së lëndës;
- *shkruajnë* dhe *prezantojnë* rreth një zhvillimi letrar dhe autorëve përfaqësues të asaj periudhe duke u përqendruar në përshkrimin e jetës në Amerikë dhe domethënies që ka kjo periudhë/vepër në letërsinë botërore.